

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2006

Viti 2006 ishte përafërsisht i balancuar me vitin para këtij në arritjen e rezultateve, mbase me një ngecje pak të hetueshme në veprimtarinë bibliotekare dhe në realizim të shërbimeve, por jo edhe në realizimin e aktiviteteve kulturore etj., që ishin të larmishme dhe të shumta. Kjo ka ndodhur për shkak të buxhetit të zvogëluar, që asnjëherë nuk u bë i njohur (si dikur) se sa ishte shuma për këtë vit që e ndan Ministria e Kulturës, prandaj nuk ishte e mundur që të realizoheshin objektivat premtues dhe të planifikuar sipas programit.

Për fat të mirë, as kësaj here nuk mungoi mbështetja e Drejtorisë për Kulturë e Komunes së Prishtinës për pasurimin e fondit të koleksioneve me libra të rinj, të përzgjedhur në bazë të kërkesave të përdoruesve. Rënia e numrit për disa dhjetëra më pak e anëtarëve përdorues në këtë vit se në vitin e shkuar, tregon më së miri për rënien e standardit familjar, prandaj do ishte mirë që një ditë anëtarësimi i tyre të bëhet falas. Por kjo aktualisht nuk mund të bëhet, sepse është e kushtëzuar nga gjendja financiare ende e pastabilizuar e Bibliotekës.

Punët profesionale

Përveç punëve profesionale si: përpunimi i librit, klasifikimi, katalogimi, printimi, puna me lexues etj., të cilat janë kryer në mënyrë profesionale, këtë vit ka përfunduar revizioni i librit të filluar në vitin 2004 në të gjithë sektorët dhe degët e bibliotekave. Janë përpunuar të gjithë librat që kanë hyrë në bibliotekë gjatë këtij viti si dhe janë hartuar projekte për pasurimin e fondeve të bibliotekës dhe degëve të saj, janë mbledhur dhe hartuar raportet dhe programet vjetore të punës që janë shqyrtuar dhe analizuar në kolegjiun profesional dhe janë dhënë sugjerime e propozime për ngritjen e efikasitetit të punës. Revizioni i koleksioneve të librit që ka filluar para dy vitesh, është kryer në mënyrë profesionale dhe deri në fund të këtij viti do të dilet me një raport të gjerë me tregues sa më të saktë të gjendjes së konstatuar në gjithë sektorët dhe shumicën e degëve.

Koordinimi i punës me bibliotekat komunale

Me qëllim të përmirësimit të kushteve të punës dhe zhvillimit të veprimtarisë bibliotekare në bibliotekat komunale në Lypjan, Fushë Kosovë, Kastriot, Besianë dhe Drenas, mbikëqyrjen profesionale të të cilave, bazuar në Ligjin për biblioteka, e ka për detyrë biblioteka jonë, gjatë këtij viti ka pasur kontakte, konsultime rreth punës profesionale dhe organizimit të sektorëve.

Është ndërhyrë edhe në qeveritë lokale dhe është kërkuar prej tyre për të bërë më shumë në përmirësimin e gjendjes, qoftë fjala për pasurimin e fondit librar apo edhe për shtimin e kuadrit me ngritje më të lartë profesionale dhe intelektuale.

Trajnimet

Këtë vit përmes stafit të bibliotekës sonë ka bërë një trajnim dyjavor në lëmin e bibliotekarisë Ismet Jashari, librar në bibliotekën e Batllavës, fshat i komunës së Besianës.

Me 22 dhe 23 mars, dy punëtorë të bibliotekës sonë kanë marrë pjesë në një trajnim të organizuar nga stafi i BKUK me temën: Formati MARC 21 dhe katalogu elektronik në programin Aleph 500.

Gjithashtu gjatë këtij viti është riorganizuar Bordi i Konsorciumit të revistave elektronike në të cilin nga bibliotekat ndërkomunale është zgjedhur përfaqësuese dhe anëtare Fatime Mehmetaj, punonjëse e kësaj biblioteke.

Pasurimi dhe përtëritja e koleksioneve dhe periodikut

Viti 2006 sa i përket pasurimit të bibliotekës me tituj të rinj, ishte përgjysmë më i varfër se vitin e kaluar. Edhe këtë vit pati mirëkuptim dhe mbështetje nga Drejtoria për Kulturë dhe Gjini e Komunës së Prishtinës. Për të katrën herë me radhë ajo po kontribuon në pasurimin e koleksioneve me libra të rinj. Këtë herë ka financuar një projekt me vlerë 5205 euro. Projekti është realizuar në fund të këtij viti dhe përmban 244 tituj me 891 kopje librash.

Vlen të përmendet edhe shfrytëzimi i rastit gjatë mbajtjes së Panairit të Librit në maj të këtij viti në Prishtinë, ku Biblioteka me të hyrat e saja nga anëtarësimi, bleu dhjetëra tituj dhe disa qindra libra për të pasuruar fondin e koleksioneve në vlerë mbi 2000 €. Në këtë formë janë blerë edhe dhjetëra libra të tjerë nga autorë të vendit. Edhe institucione dhe individë i kanë dhuruar libra kësaj biblioteke. Në vitin 2006 kanë hyrë në bibliotekë gjithsej 703 tituj me 2792 kopje të librave. Prej tyre, libra të blerë 511 tituj me 2619 kopje dhe libra të dhuruar me 172 tituj që bëjnë 955 kopje.

Me mjete të Bibliotekës gjithashtu janë blerë DVD-i për dy biblioteka për fëmijë dhe 57 CD-rom me përmbajtje edukative dhe arsimore.

Gjithashtu furnizimi me periodik ishte në nivel. Në bibliotekën qendrore janë marrë 6 gazeta të përditshme, të cilat u janë në shërbim të lexuesve: “Koha ditore“, “Zëri“, „Epoka e re“, “Lajmi”, “Bota sot” dhe “Iliria post”; radhës së revistave tashmë i është shtuar edhe revista letrare “Oaza” që e boton kjo bibliotekë. Sikurse viteve të tjera, u bë lidhja e tri gazetave ditore: ”Bota sot”, ”Koha ditore“, dhe “Zëri”. Gazeta “Bota sot” është ndalë së botuari dhe nuk del që nga muaji nëntor.

Aktivitetet bibliotekare dhe kulturore

Shpërblimet dhe mirënjohjet:

Edhe këtë vit u organizuan aktivitete të shumta në lëmin e bibliotekarisë dhe në fushën e kulturës që kanë të bëjnë jo vetëm me librin dhe bibliotekën, por edhe më shumë së kaq.

Në fillim të vitit, sipas traditës së bibliotekës, por për të fundit herë, u mbajt manifestimi i dhënies së shpërblimeve për lexuesit më të dalluar, mirënjohje për dhuruesit më të njohur dhe u shpallën 10 librat me të lexuar gjatë vitit për vitin 2005.

Lexuesit më të dalluar për vitin 2005 u shpallën: **Dilaver Polisi**-nxënës, **Valmira Lushtaku**- studente dhe **Enver Pireva**- punëtor.

“Java e Bibliotekës në Kosovë” u shënua edhe këtë vit dhe ishte e pasur me aktivitete dhe ligjërata profesionale nga bibliotekaria të ekspertëve nga Amerika, Franca dhe Kosova. Biblioteka jonë u inkuadrua në këtë aktivitet shumë të rëndësishëm me tri tema: ”Bibliotekat publike në shërbim të çdo komuniteti” nga Sylejman Pireva, “Gjendja e bibliotekave para automatizimit” nga Fatime Mehmetaj dhe “Aktivitetet në degët “Përrallat dhe “Biblioteka Përkujtimore” nga Xhemail Luta, të cilat u ndoqën me interesim nga të pranishmit.

Pjesëmarrja në Konferencën Shkencore për çështje të bibliotekarisë në Tiranë (e para e këtij lloji) e kësaj biblioteke përmes drejtorit të saj, Sylejman Pireva, me kumtesën me titull “Bibliotekat publike dhe qeveria” ishte edhe një sukses tjetër i kësaj Biblioteke.

Shpallja e Konkursit letrar nga Biblioteka, tashmë tradicional, këtë herë solli këtë risi: u vendos që të shpallet për tri gjini letrare, për poezi, tregim dhe ese. Pas arritjes së punimeve të kandidatëve konkurrues, Juria e përbërë nga studiuesi dhe shkrimtari Begzat Baliu, kryetar dhe Veli Veliu e Sylejman Pireva, anëtarë, vendosën dhënien e të tria shpërblimeve për tri zhanret. Shpallja e rezultateve të konkursit dhe dorëzimi i shpërblimeve u bë në mënyrë solemne dhe me pjesëmarrje solide nga mysafirë të ftuar dhe gazetarë të mediave.

Takimet me shkrimtarë dhe krijues

Këtë vit u mbajtën disa takime me krijues në degën „Biblioteka Përkujtimore“ dhe në degën „Përrallat“.

Në degën „Biblioteka Përkujtimore“ u përgatit program për nder të festave të 7 dhe 8 marsit, Ditës së Mësuesit dhe Ditës së Gruas. Mysafir këtë herë ishte ftuar veterania e arsimit, znj.Ganimete Meka, mësuese në shk.fillore “Pjetër Bogdani”, e cila evokoi kujtimet e saja për punën shumëvjeçare me nxënës. Lexuesit dhe punonjësit e kësaj biblioteke dhanë një program të pasur letrar-artistik, kurse më të mirët u shpërblyen me libër.

Me 2 prill u mbajt për herë të dytë në Kosovë Dita ndërkombëtare e librit për fëmijë në bashkëpunim me Karvanin e Shkrimtarëve. Këtë vit mesazhin dhe posterin e kishte prezantuar shteti i Sllovakisë. Ishte ftuar të marrë pjesë shkrimtari i mirënjohur për fëmijë, Rexhep Hoxha, të cilin Biblioteka e shpërbleu me mirënjohje dhe me një honorar, si veproi edhe disa të tjerë. Drejtori i bibliotekës shfrytëzoi këtë rast dhe doli me propozimin që edhe Kosova të bëhet anëtare e IBBY-t, iniciativë kjo që u përkrah nga të pranishmit.

Po nga kjo degë u organizua një vizitë në lokalitetin arkeologjik në Bardh të Madh, ku janë duke u bërë gërmime dhe hulumtime të pasurisë sonë nga arkeologjia. Interesimi i lexuesve për arkeologjinë u pa nga pyetjet e panumërta që ata i bënë arkeologut të hulumtimeve.

Në “Natën e Shtrigave” u organizua program interesant dhe i larmishëm nga lexuesit e kësaj dege, nën përkujdesjen e bibliotekares dhe kolegeve të saj.

As këtë vit kjo bibliotekë nuk lëshoi rastin pa e shënuar datën e 28 Nëntorit-Ditën e Flamurit, nga një program i larmishëm i shfaqur nga vetë lexuesit e saj.

Gjatë këtij viti në degën “Biblioteka Përkujtimore” u realizuan katër emisione televizive për fëmijë nga RTK.

- Emisioni i parë është bërë me fëmijët parashkollorë ku u prezantuan aktivitetet e ndryshme që mbahen në këtë bibliotekë.
- Emisioni i dytë kishte të bëjë me prezantimin e veprës “Sarajet e bardha” të shkrimtarit Vehbi Kikaj
- Në emisionin e tretë u prezantua libri “Zilja e fëmijërisë” të shkrimtarit për fëmijë Xhevat Syla.
- Dhe në emisionin e fundit shkrimtari Faik Shkodra, së bashku me lexuesit e bibliotekës biseduan për librin “Lugjet e verdha” të shkrimtarit Rexhep Hoxha.
- Edhe në degën “Përrallat” u realizua një emision për aktivitetet me fëmijë.

Në degën “Përrallat u organizua një takim i lexuesve me moderatoren e RTK-së, zonjushën Manushaqe Kryeziu, e cila bashkëbisedoi me lexuesit dhe foli për profesionin e saj shumë tërheqës. Gjithashtu u mbajt edhe një takim me sociologun Nurie Fazliu-Kelmendi, e cila u shpjegoi fëmijëve për Konventën e të drejtave që gëzojnë fëmijët. Bashkëbisedimi ishte shumë interesant dhe i dobishëm. Në të dy takimet u dha një program i pasur dhe i larmishëm nga lexuesit e bibliotekës dhe nën përkujdesjen punonjësve të saj.

Aktiviteti i Klubit të Letrarëve të Rinj “Oaza” të Bibliotekës

- Mbajtja e orës letrare me rastin e shpalljes së rezultateve të Konkursit letrar, nga krijuesit e shpërblyer dhe konkurruesit e tjerë;
- Takimi i rëndësishëm me rastin e shënimit të 70 vjetorit të lindjes së shkrimtarit tonë të njohur Ismail Kadare me një orë të madhe letrare si dhe përrurimi i numrit të tretë të revistës letrare “Oaza”. Për punën krijuese dhe jetën letrare të Kadaresë foli bibliotekari dhe shkrimtari Veli Veliu. Në këtë tubim morë pjesë edhe krijuesit të Karvanit të Shkrimtarëve, të Lidhjes së Shkrimtarëve, klubet letrare nga Fushë Kosova, Kastrioti, Podujeva si dhe përfaqësues të qendrës kulturore nga Presheva të cilët u prezantuan me nga një krijim letrar; një fjalë rasti mbajti edhe shkrimtari dhe veprimtari i shquar, z. Adem Demaçi që është edhe kryetar i LSHK;
- njoftimi me grupet letrare të shkollave të mesme dhe lidhja me to për bashkëpunim me KLR “Oaza” të Bibliotekës;
- pjesëmarrja me anëtarë të KL të Bibliotekës në takimin promovues dhe letrar në Kastriot me Klubin letrar “Fahri Fazliu”;

Botimet:

- revista letrare “Oaza” nr. 1/Viti III dhe nr. 2/Viti III;
- Gjon Keka: Kosova drejt pavarësisë dhe integritit.

Promovimet:

- Në ambientet e “Bibliotekës Përkujtimore” u promovua libri i Shqipe Pacollit “Dhembja jote”
- Në amfiteatrin e BKUK u promovua libri “Kosova drejt pavarësisë dhe integritit” të autorit Gjon Keka.

Ekspozitat:

- çelja e ekspozitës me libra të rinj në sallën e leximit nga Projekti i financuar prej Drejtoratit për Kulturë i komunës së Prishtinës me rastin e dhënies së shpërblimeve dhe mirënjohjeve për lexuesit më të mirë, librat më të lexuar, dhuruesit më të dalluar etj.

Bashkëpunimi ndërkombëtar

Në muajin maj u nënshkrua marrëveshja për bashkëpunim me bibliotekën e qytetit të Preshevës. Solemniteti i nënshkrimit u bë në Preshevë me rastin e 61 vjetorit të themelimit të kësaj biblioteke. Të pranishëm ishin personalitete të njohura të jetës kulturore dhe politike nga komuna e Preshevës dhe nga Kosova.. Me këtë rast biblioteka jonë dhuroi një sasi librash: 54 tituj me 130 kopje.

Renovimet dhe pajisja me inventar

Këtë vit ka pasur fare pak përtëritje të inventarit, kurse dhe më pak renovime për shkak të mungesës së mjeteve financiare.

**Prishtinë,
26 dhjetor 2006**

**Drejtori,
Sylejman Pireva**